Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (DAKRS)
Nr. 7-30
Datë: 18.09.2026

Bazuar në nenin 77, 78, 79, 80, 81 dhe nenin 82 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenin 35 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar nr. 04/L-32, nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nenet 6, 7 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, nenet 8, 9 dhe 10 të Rregullores (QRK) 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenet 4, 5, 6 dhe 7 të Rregullores (QRK) nr. 27/2024 për Procedurat e Konkurrimit për Nëpunësit Teknikë dhe Mbështetës, Udhëzimit Administrativ MFPT nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Komuna Junik, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Për pozitat e lira, si në vijim:

Emri i Grupit : Grupi Arsimor
Institucioni : Komuna Junik
Departamenti : Drejtoria e Arsimit
Shkolla/IP: Institucioni Parashkollor "Yjet e Gjeravicës"

Data e njoftimit: 18.09.2026
Lloji i pozitave: Nëpunës i Shërbimit Publik
Afati i aplikimit: 19.09.2026 - 18.10.2026
Kohëzgjatja e emërimit : E pacaktuar
Nr. i kërkuar : Tre (3)

1. Pozita e lirë për vitin shkollor 2026/27):

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Vendi i punës
1.	Një (1) Edukatore në çerdhe 0-3 vjeç	5.2	Junik
2.	Një (1) Edukatore ndihmëse në çerdhe 0-3 vjeç	5.1	Junik
3.	Një (1) Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e 2	4.8	Junik

2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës për Edukatore dhe Edukatore Ndihmëse 0–3 vjeç

- Të realizojë plan-programin edukativ për vendin përkatës të punës, duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore;
- Të përcjellë dhe dokumentojë përparimin e fëmijëve, duke shfrytëzuar instrumentet specifike për monitorimin dhe dokumentimin e zhvillimit të fëmijëve, si dhe të aplikojë vlerësimin formativ nga perspektiva e ofrimit të udhëzimeve, këshillave, motivimit dhe përkrahjes për fëmijët;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor, në përputhje me kurrikulën dhe në pajtim me kërkesat për përshtatjen e edukimit, aftësive dhe prirjeve individuale të çdo fëmije të moshës 0–3 vjeç;
- Të diskutojë përparimin e fëmijëve me prindërit dhe t'i këshillojë ata në lidhje me aktivitetet që ndihmojnë zhvillimin e fëmijëve;
- Të bashkëpunojë me organet e institucionit dhe me të gjitha institucionet e tjera profesionale;
- Të kryejë edhe punë të tjera të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për Kuzhinier/e

- Në mënyrë cilësore të përgatisë dhe të shpërndajë ushqimin për fëmijët, si dhe të sigurojë higjienën në kuzhinë dhe në sallën e ushqimit të çerdhes;
- Të krijojë kushte për gatim të pastër dhe të rregullt; të rregullojë defektet e vogla, ndërsa për ato që nuk mund t'i rregullojë vetë, të informojë teknikun dhe drejtorin e çerdhes;
- Varësisht nga vëllimi i punës, kuzhinieri/ja mund të angazhohet edhe në punë shtesë, në kuadër të javës 40-orëshe të punës;
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon;
- Të kujdeset për pastërtinë e objektit, mjeteve të punës dhe artikujve ushqimorë;
- Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime për kryerjen e detyrave të punës nga askush tjetër, përveç drejtorit të çerdhes dhe DAKRS-së;
- Të mos e shfrytëzojë pozitën e punës për interesa të një pale të tretë, përfshirë familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij/saj;
- Të bëjë porosinë e artikujve të nevojshëm ushqimorë dhe të kujdeset për ruajtjen dhe afatin e përdorimit të tyre;
- Gjatë kohës së pushimeve, të kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirës dhe pajisjeve, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në kuzhinë.

3. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e Edukatores dhe Edukatores Ndihmëse 0–3 vjeç

- Të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i/e aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

4. Kërkesat e përgjithshme formale për Edukatore dhe Edukatore Ndihmëse

- Sipas UA Nr. 05/2021 – Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e Kuzhinierit/es

- Të ketë të kryer arsimin e mesëm;
- Të ketë së paku 1 (një) vit përvojë pune përkatëse;
- Të ketë certifikatë ose diplomë për kuzhinier/e.

5. Dokumentacioni/dëshmitë përkatëse për vlerësimin e përmbushjes së kritereve për aplikim

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Kopja e dokumentit të identifikimit (letërnjoftimit);
- Kopja e diplomës e vërtetuar te noteri;
- Diploma e fituar jashtë shtetit duhet të jetë e nostrifikuar;
- Certifikata e diplomimit, jo më e vjetër se gjashtë muaj, e vërtetuar te noteri (vlen vetëm për kandidatin/en që ende nuk është pajisur me diplomë nga institucioni ku ka përfunduar studimet);
- Certifikata e lëshuar nga Gjykata, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka kryer ndonjë vepër penale me dashje, jo më e vjetër se gjashtë muaj;
- Kandidatët që kanë përvojë pune duhet të dorëzojnë vërtetimin e përvojës së punës në mësimdhënie, si dhe portofolin profesional me përmbledhjen e punës së tyre;
- Vërtetimi nga Zyra e Punësimit;
- Ekstrakti i lindjes.

6. Mënyra e aplikimit

- Aplikacionet merren në Zyrën Pritëse, në ndërtesën e Komunës së Junikut, dhe të plotësuara dorëzohen në Zyrën Pritëse.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta do të refuzohen.

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Vlerësimi i jetëshkrimit (CV) – deri në 20 pikë;
- Testi me shkrim – deri në 50 pikë;
- Intervista me gojë – deri në 30 pikë;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve në testin me shkrim i nënshtrohen intervistës me gojë;
- Pikët nga vlerësimi i jetëshkrimit (CV), testi me shkrim dhe intervista me gojë mblidhen në shumën e përgjithshme, dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen për pozitat e lartcekura;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i nostrifikojnë diplomat nga MASHT-i;
- Për intervistë do të ftohen kandidatët që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura;
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, pasi që nuk kthehen.

8. Sqarime shtesë

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në ueb-faqen e Komunës së Junikut, në tabelën e shpalljeve në objektin e Komunës dhe përmes telefonit mobil, pas mbylljes së konkursit.

Drejtor i DAKRS

Xhavit Velijaj

VII
JUNIK